



BASHKIA ELBASAN



POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

*Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve është një dokument udhëheqës
për stafet, prindërit, partnerët e vullnetarët në institucionet edukative parashkollore
nën administrimin e Bashkisë Elbasan në të cilat punohet me / për fëmijë,
për të mbrojtur dhe ruajtur mirëqënien e fëmijëve nga çdo formë e dhunës apo abuzimit.*



POLITIKA PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE

I. Hyrje

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe keqtrajtimi është një dokument i përgatitur nga Bashkia Elbasan në bashkëpunim me profesionistë, stafe të kopshteve dhe cerdheve nën administrimin e Bashkisë si dhe ekspertë të fushës që punojnë për realizimin e të drejtave të fëmijëve në vend.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve është një dokument udhëheqës për stafet, prindërit, partnerët e vullnetarët në institucionet edukative parashkollore nën administrimin e Bashkisë Elbasan në të cilat punohet me / për fëmijë, për të mbrojtur dhe ruajtur mirëqenien e fëmijëve nga çdo formë e dhunës apo abuzimit.

Ky dokument kërkon të nxisë garantimin e një sjelljeje institucionale, më të përgjegjshme në kopshtet dhe çerdhet e Bashkisë Elbasan në funksion të krijimit të ambjenteve më të sigurta për të gjithë fëmijët.

Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve ka udhëzime dhe procedura të qarta të cilat do t'i ndihmojnë stafet e cerdheve dhe kopështeve në identifikimin e rasteve të abuzimit në mjediset e institucionit si dhe raportimin apo referimin e çdo rasti të abuzimit të fëmijëve.

Rëndësia e kësaj politike shtrihet në qartësimin e roleve, përgjegjësi, procedurave dhe rregullave për shqetësime që dalin lidhur me mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu ajo ndihmon cerdhet dhe kopështet të përmbushin detyrimet ligjore lidhur me mbrojtjen e fëmijëve.

Kjo është një politikë obmrellë e cila nuk përjashton krimimin e politikave më të detajuara në kopshtet dhe çerdhet. Ajo synon të vendosë disa pika referimi në lidhje me rastet e mundshme të dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve.

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen e shoqates Terre des Homme Shqipëri, Platforma Rajonale për Mbrojtjen e Fëmijëve.(CHILD-HUB)

II. Qëllimi dhe parimet e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve është një dokument që ka për qëllim të mbrojë të gjithë fëmijët në kopështet dhe cerdhet e Bashkisë Elbasan nga dhuna dhe abuzimi.

Qëllimi i politikës dhe procedurave të saj është të rregullojë mënyrën e mbrojtjes së fëmijëve gjatë veprimtarisë në çerdhet dhe kopështet e Bashkisë Elbasan.

Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve është rikonfirmim i përkushtimit të Bashkisë Elbasan për të mbrojtur fëmijët. Ajo promovon krijimin e standardeve për të siguruar që mënyra me të cilën Bashkia dhe partneret e kryejnë punën e tyre është një mënyrë që nuk i dëmton fëmijët.

Politika bazohet në legjislacionin Shqiptar për arsimin parauniversitar, Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, Ligjin për të Drejtat dhe mbrojtjen e Fëmijëve nr/18/2017

Përse nevojitet një Politikë për Mbrojtjen e Fëmijëve?

Abuzimi i fëmijëve është një problem real i shoqërisë dhe një fenomen mjaft delikat dhe kërkon trajtim profesional pasi:

- Fëmijet për nga mosha dhe statusi janë pjesa më e pambrojtur ndaj abuzimeve
- Shpesh herë edhe vetë profesionistët që punojnë me fëmijët mund të mos i dallojnë shenjat e abuzimit tek fëmijët.
- Shumica e abuzimeve kryhen nga njerëz, të cilët fëmijët i njohin dhe u besojnë.
- Në shumicën e rasteve ky abuzim mund të parandalohet.
- Ka një rrezik në rritje sidomos për kategori të caktuara si : fëmijët me nevojë të veçanta, fëmijët e braktisur ose fëmijët që jetojnë në kushte të vështira dhe që janë shumë vulnerabël.

Për kë vlen Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve?

- Politika vlen për të gjithë ata të cilët punojnë në institucionet kopësht/cerdhe të Bashkinë Elbasan duke përfshirë stafin, vullnetarët dhe partnerët.
- Politika është OBLIGATIVE. Është kusht për angazhim në strukturën e Bashkisë që të vepron në pajtim me politikën.
- Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve përqendrohet në kontaktin me fëmijët gjatë punës në institucionet kopësht/cerdhe të Bashkisë.

Politika e Mbrojtjes bazohet në një sërë parimesh dhe besimesh, duke përfshirë:

- Të gjithë fëmijët kanë të drejtë për t'u mbrojtur, për tu rritur dhe zhvilluar në mjedise të sigurta.
- Të gjitha veprimet lidhur me mbrojtjen e fëmijëve duhet të ndërmerren duke mbajtur parasysh interesin e tyre më të lartë.
- Mbrojtja është përgjegjësi e të gjithëve. Kjo politikë është e detyrueshme për të gjithë ata që punojnë për apo në emër të Bashkisë, duke përfshirë stafin, vullnetarët dhe partnerët. Të gjithë duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive që të përmbushin përgjegjësitë e tyre në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.
- Në punojmë në mënyrë transparente dhe të hapur, ku prioritet është mbrojtja e fëmijëve, duke qenë të ndërgjegjshëm se situatat e abuzimit dhe dëmtimit mund të shfaqen kur stafi, vullnetarët, partnerët, fëmijët, familjet dhe anëtarët e komunitetit nuk kanë mundësi të ngrenë shqetësimet e tyre.
- Të gjitha raportimet për shqetësimet lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve do të trajtohen me seriozitet. Në rastet ku do të jetë e nevojshme, do të ndërmerren hapat e duhur për mbrojtjen e fëmijëve dhe masa kundër autorëve të dyshuar.
- Asnjë institucion nuk është në gjendje t'i mbrojë fëmijët duke punuar veçmas, prandaj ne do të punojmë me organizata, agjenci, edukatorë dhe prindër.
- Ne ruajmë konfidencialitetin dhe nuk zbulojmë detajet personale të personave të përfshirë në çështjet e mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë emrat e atyre që ngrenë shqetësimet me përjashtim të rasteve kur përcjellja e informacionit është e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e fëmijës.
- Ne përpiqemi të ndërgjegjësojmë dhe të ndikojmë tek të tjerët për rëndësinë e mbrojtjes së fëmijëve, duke e përdorur politikën dhe procedurat tona si një mënyrë si për të theksuar përkushtimin tonë, ashtu edhe për sqarimin e vlerave tona. Ne do ta ndajmë politikën dhe procedurat tona me të tjerët, dhe do të jemi të hapur për reagime në lidhje me zbatimin dhe rëndësinë e tyre.

- Ne punojmë në kuadër të ligjeve dhe politikave kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me mbrojtjen.
- Nuk ka një mënyrë specifike për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Zgjidhjet për mbrojtjen e fëmijëve duhet të pasqyrojnë kulturën, mjedisin e veprimtarisë dhe natyrën e veprimtarive që ndërmerren. Por, kultura nuk duhet të përdoret asnjëherë për të përligjur abuzimin.

III. Zbatimi i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve

Stafi, praktikantët, vullnetarët:

- Politika e Mbrojtjes së Fëmijëve vlen për të gjithë ata që punojnë me, apo në emër të Bashkisë Elbasan. Duke pranuar kushtet e punës me/për institucionet kopeshit/cerdhe, rrjedhimisht pranohen edhe qëllimet dhe kushtet e Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve, si kusht për përfshirje.
- Të gjithë anëtarëve të stafit kopeshit/cerdhe (duke përfshirë konsulentët dhe vullnetarët aktivë) u kërkohet të nënshkruajnë dhe t'i binden **Kodit të Sjelljes** si kusht për përfshirjen e tyre në keto institucione parashkollore të Bashkisë Elbasan. Ky Kod përcakton pritshmëritë specifike në lidhje me sjelljet e pranueshme dhe të papranueshme.
- Shkelja e Kodit të Sjelljes, apo e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve mund të çojë në pezullim apo ndërprerje të çfarëdolloj angazhimi.
- Stafi dhe partnerët, komunitetet, familjet, fëmijët dhe palët e tjera të interesit dhe të gjithë ata që punojnë me/për Bashkinë, vihen në dijeni për Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe për mënyrën se si mund të raportohet një shqetësim.

Kodi i Sjelljes

Kodi i Sjelljes duhet të nënshkruhet nga i gjithë stafi dhe vullnetarët PARA fillimit të kryerjes së detyrave në institucionet kopeshit/cerdhe.

Bashkia Elbasan i konsideron të gjitha format e dhunës dhe abuzimit ndaj fëmijëve të papranueshme.

Neglizhimi, dhuna fizike, psikologjike/emocionale dhe seksuale janë format kryesore të abuzimit.

Fëmijë është çdo qenie njerëzore nën moshën 18-vjeçare siç përcaktohet në Konventën e

OKB-së për të Drejtat e Fëmijës, 1989.

*I gjithë stafi (duke përfshirë të punësuarit me pagesë, këshilltarët dhe praktikantët), me orar të plotë apo të pjesshëm, duhet të pranojnë Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe në mënyrë specifike të pranojnë të punojnë në përputhje me **Kodin e Sjelljes**, i cili paraqet përgjegjësitë për mbrojtjen e fëmijëve dhe pritshmëritë për sjelljen e stafit.*

KY KUSHT ËSHTË I DETYRUESHËM.

Çdo formë e sjelljes së papranueshme e cila e shkel Kodin e Sjelljes duhet të raportohet. Në rastin e situatave të cilat nuk mbulohen në Kodin e Sjelljes, Bashkia pret nga përfaqësuesit e saj të japin gjykime të drejta duke i dhënë përparësi “interesit më të lartë të fëmijës”.

Bashkia Elbasan respekton Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe parimet në vijim:

1. **Të drejtat e fëmijëve:** *I gjithë stafi i Bashkisë duhet t'i respektojë dhe promovojë të drejtat e fëmijëve. Para së gjithash, ata duhet të mbrojnë të drejtën e secilit fëmijë që të jetojë i sigurt, pa qenë i rrezikuar nga abuzimi apo shfrytëzimi dhe duhet të punojë gjithmonë, për interesat më të mira të fëmijës.*
2. **Zero tolerancë:** *Bashkia nuk toleron asnjë formë të abuzimit dhe merr masat e nevojshme për të zbatuar politikën për mbrojtjen e fëmijëve.*
3. **Përgjegjësia e secilit:** *Zbatimi i suksesshëm i politikës për mbrojtjen e fëmijëve bazohet në përgjegjësinë individuale dhe të përbashkët të të gjithë stafëve dhe përfaqësuesve të Bashkisë.*
4. **Detyra për njoftim:** *Çdo shkelje e dyshuar apo çdo shkelje e vërtetuar e Kodit të tanishëm të Sjelljes duhet t'i raportohet menjëherë personit të kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve pranë Bashkisë. Konfidencialiteti do të ruhet gjatë gjithë procedurës.*

Duke nënshkruar kodin e sjelljes, UNË bie shprehimisht dakord që:

Në çdo rast:

- *Do ti trajtoj fëmijët me respekt dhe në mënyrë të barabartë, pavarësisht moshës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit apo kombësisë, origjinës sociale apo etnike, statusit, klasës, kastës, orientimit seksual apo ndonjë karakteristike tjetër.*
- *Do ti ndihmoj fëmijët që të marrin pjesë në vendime, të cilat kanë të bëjnë me ta sipas moshës dhe nivelit të tyre të pjekurisë.*
- *Do të ruaj një kulturë komunikimi dhe krijoj besim te fëmijët dhe familjet e tyre, komunitetet, stafi dhe vullnetarët e tjerë në mënyrë që të mund të ndahen dhe diskutohen shqetësimet.*
- *Do të përdor metoda që përfshijnë sjellje jo të dhunshme dhe pozitive gjatë mbikëqyrjes së fëmijëve.*
- *Do të nxis fëmijët dhe komunitetet të flasin haptas rreth ndërveprimeve të tyre me të rriturit dhe njëri-tjetrin.*
- *Do ti informoj fëmijët dhe komunitetet për të drejtat e tyre për të raportuar çdo situatë shqetësuese dhe se si ata mund të ngrenë një shqetësim.*
- *Do ti fuqizoj fëmijët në mënyrë që ata të jenë në gjendje të mbrojnë veten më mirë.*
- *Përpiqem të ruaj pavarësinë e fëmijës dhe siguroj që të mos kryej veprime të cilat një fëmijë mund t'i kryejë vetë.*
- *Planifikoj aktivitete dhe organizoj vendin e punës në mënyrë të tillë që zvogëlon rrezikun e dëmit duke pasur parasysh moshën dhe zhvillimin e fëmijës.*
- *Do të sigurohem që informacionet lidhur me fëmijët, familjet dhe komunitetet të mbeten konfidenciale.*
- *Do të sillem në një mënyrë që paraqet një shembull të mirë (shmang konsumin e duhanit, nuk shpreh mungesë respekti ndaj kolegëve, etj.).*

- Do të marr leje nga fëmijët dhe prindërit e tyre para fotografimit, incizimit apo përdorimit të imazhit të fëmijës, për atë që ata kanë thënë apo historinë e tyre. Kjo përfshin edhe shpjegimin e mënyrës sesi do të shfrytëzohen fotografitë. Ky shpjegim do t'iu jepet fëmijëve dhe prindërve të tyre.
- Do të sigurohem se fëmija nuk paraqitet në një mënyrë degraduese apo në një mënyrë që mund të interpretohet nga të tjerët se ka ngjyrim seksual.
- Do të ngre çdo shqetësim dhe dyshim në lidhje me Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve tek personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve.
- Do të raportoj menjëherë çdo dyshim apo akuzë tek personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve për sjellje në kundërshtim me parimet e politikës për mbrojtjen e fëmijëve dhe Kodit të Sjelljes, duke përfshirë çdo formë të abuzimit me fëmijët, edhe nëse informacionet apo akuzat janë të paqarta.

Në asnjë rast nuk do të:

- Përfshihem në asnjë formë të marrëdhënieve seksuale me dikë nën moshën 18-vjeçare, pavarësisht moshës ligjore kur lejohet përfshirja në veprimtari seksuale, sipas ligjit dhe zakoneve vendore. Keqkuptimi për moshën e fëmijës nuk mund të përdoret si mbrojtje.
- Këmbej paratë, punën, mallrat, shërbimet apo ndihmën humanitare për ndere seksuale apo ta nënshtroj fëmijën ndaj një lloji tjetër të sjelljes poshtëruese, degraduese apo abuzive.
- Prek fëmijët, përdor gjuhën apo bëj sugjerime në mënyrë të papërshtatshme, të provokoj, ngacmoj apo poshtëroj fëmijën apo të shfaq mungesë respekti ndaj praktikave kulturore. Kjo përfshin të vepruarit në një mënyrë që mund të ketë ndikim negativ në vetëbesimin e fëmijës dhe ndjenjat e vetëvlerësimit.
- Shfrytëzoj fëmijën për punë.
- Diskriminoj, trajtoj fëmijët në mënyrë të pabarabartë apo të padrejtë, për shembull duke favorizuar dhe përjashtuar të tjerët.
- Ftoj një fëmijë apo të afërmit e tyre në shtëpinë time apo krijoj një marrëdhënie me fëmijët dhe/ose familjet e tyre, e cila mund të konsiderohet të jetë jashtë kufijve normalë profesionalë.
- Punoj apo transportoj një fëmijë vetëm pa autorizim paraprak të institucionit tim, veç nëse është absolutisht e nevojshme për sigurinë e fëmijës.
- Jem nën ndikimin e drogave apo alkoolit ndërkohë që punoj me fëmijë.
- Fotoj apo bëj video për përdorime të tjera që nuk janë rreptësisht profesionale përveç rasteve kur institucioni jep leje.
- Shikoj, publikoj, prodhoj apo shpërndaj pornografi me fëmijë, dhe/apo t'iu shfaq fëmijëve materiale pornografike.
- Fotoj apo publikoj fotografi të fëmijëve plotësisht të zhveshur apo të veshur në një mënyrë që nuk i përshtatet situatës në të cilën ata gjenden.
- Paraqes fëmijët si viktimë (të dobët, të pafuqishëm, pa ndihmë, të dëshpëruar, etj.).
- Publikoj një histori apo imazh i cili mund të rrezikojë fëmijën, familjen e tyre apo komunitetin).
- Përdor fotografi të cilat nuk janë kontrolluar apo miratuar nga institucioni apo postoj fotografi jozyrtare apo informacione rreth fëmijëve në faqet tona personale të internetit apo rrjetet sociale (si Facebook).
- Mbaj kontakt me fëmijët dhe familjet e tyre nëpërmjet rrjeteve sociale, vetëm nëse më është dhënë leja e shprehur.

- Hesht,shpërfill apo dështoj në raportimin e ndonjë shqetësimi, dhune të dyshuar apo shkelje të politikës për mbrojtjen e fëmijëve dhe Kodit të Sjelljes tek Personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve.

Unë e kuptoj që, në rast të dyshimeve apo akuzave për shkelje nga ana ime të Kodit të Sjelljes

Bashkia do të ndërmarrë çfarëdo veprimi që ata e konsiderojnë të nevojshëm, që mund të përfshijë por jo të kufizohet, me:

- Ofrimi i ndihmës për viktimën dhe ndërmarrja e hapave të menjëhershëm për të mbrojtur dhe përkrahur fëmijën.
- Përpjekjet për të vërtetuar faktet në mënyrën më të mundshme objektive (mbizotëron supozimi i pafajësisë) ndërsa mbrohen reputacioni dhe konfidencialiteti i të rriturve të përfshirë.
- Ndërmarrja e veprimeve disiplinore, të cilat mund të rezultojnë me pezullim apo ndërprerjen të kontratës.
- Nisja e procedurave gjyqësore dhe/ose raportimi i autoriteteve kompetente çdo shkelje të Kodit të Mirësjelljes e cila mund të shkelë legjislacionin kombëtar.
- Marrja e masave të duhura me qëllim sigurimin që incidente të tilla të mos përsëriten, të cilat mund të kërkojnë referenca profesionale lidhur me ndërprerjen e kontratës për shkak të shkeljes së parimeve të mbrojtjes së fëmijëve (në kuadër të kornizës legjislative të aplikueshme për mbrojtjen e informacionit).

Deklaratë e zotimit

Unë, i nënshkruari,.....

Deklojoj se e kam marrë, lexuar dhe kuptuar Kodin e Sjelljes së Bashkisë Elbasan dhe angazhohem për ta njohur dhe bie dakord të punoj në përputhje me të.

Unë e kuptoj se çdo rast i mosrespektimit të Kodit të Sjelljes mund të çojë në ndërprerjen e angazhimit tim si dhe procedura tjera disiplinore apo gjyqësore siç është përmendur më lart.

Veç kësaj, unë deklaroj se nuk kam dosje penale lidhur me shkelje ndaj fëmijëve (të cilën nuk e kam deklaruar më parë) dhe as nuk jam në dijeni të ndonjë arsyeje për të cilën dikush mund të më konsiderojë si të papërshtatshëm për të punuar me fëmijë. Bashkia Elbasan rezervon të drejtën për të njoftuar institucionet e tjera të cilat mund të kërkojnë referenca profesionale lidhur me ndërprerjen e kontratës për shkelje serioze të parimeve të mbrojtjes së fëmijëve në kuadër të kornizës legjislative të aplikueshme për mbrojtjen e informacionit.

Data.....në.....

Nënshkrimi.....

Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve

Cdo cerdhe dhe kopësht nën administrimin e Bashkisë Elbasan vendos Personin e Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Emri i personit në cdo njësi dërgohet pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve të Bashkisë menjëherë pas aprovimit zyrtar të Politikës.

Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve në kopësht/çerdhe bëhet pjesë e mekanizmit të identifikimit dhe menaxhimit të rasteve.

Roli i këtij personi është të shërbejë si një pikë kontakti, dhe të këshillojë, mbështesë dhe ndihmojë stafet në kopështe dhe çerdhe në zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Roli i personit të kontaktit duhet t'i caktohet një personi që ka njohuri për zhvillimin, nevojat dhe të drejtat e fëmijëve. Megjithatë, roli mund t'i caktohet kujtdo që është i përkushtuar dhe e respekton ekipin.

Personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve nuk është përgjegjësi i vetëm për mbrojtjen e fëmijëve, pasi kjo përgjegjësi është e të gjithëve.

Personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve në kopsht/cerdhe është burimi i parë i këshillimit dhe përkrahjes në lidhje me çështjet për mbrojtjen e fëmijëve dhe zbatimin e Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Bashkia do të vërë në dispozicion informacion të vazhdueshëm dhe profesional për kopshtet dhe cerdhet për mbrojtjen e fëmijëve.

Çdo rast ku kërkohet mbështetje apo këshillim lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, duhet trajtuar me seriozitet.

Në rastet kur persona që punojnë me/për Bashkinë Elbasan janë të përfshirë në incidente që kanë të bëjnë me mbrojtjen e fëmijëve, qoftë si subjekt i një hetimi apo si dëshmitar, duhet ofruar mbështetja e duhur.

Rolet dhe përgjegjësitë e Personit të Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve në kopështe/çerdhe:

Detyrat specifike përfshijnë:

- Të veprojnë si pikë kryesore e kontaktit në institucionin cerdhe apo kopësht për mbrojtjen e fëmijëve.
- Të sigurojnë që stafi dhe partnerët janë në dijeni të politikës për mbrojtjen e fëmijëve dhe përgjegjësitë e tyre sipas saj.
- Të këshillojnë dhe përkrahë stafin dhe partnerët në zbatimin e politikës së mbrojtjes.
- Të krijojnë lidhje me specialistët vendorë për mirëqenien dhe shëndetin e fëmijëve me qëllimin që nëse një incident ndodh dhe/ose nevojitet këshillim i jashtëm të ketë në dispozicion informacione prej tyre.
- Të sigurojnë që politika e mbrojtjes iu janë bërë të njohura fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve dhe që politika është e hapur për të gjithë.
- Të sigurojnë që të jenë në dispozicion emri dhe hollësitë e kontaktit të personit përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve, në mënyrë që njerëzit të dinë se si mund të ngrenë një shqetësim/ku të kërkojnë këshillim.

- Të veprojnë si pika e parë e kontaktit për shqetësimet lidhur me incidentet për mbrojtjen e fëmijëve dhe t'i ngrejë ato shqetësime te Drejtuesi dhe/apo Punonjesi për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki.
- Të mbajë të dhëna të sakta për incidentet.
- Të përkrahë zbatimin dhe monitorimin e politikës për mbrojtjen e fëmijëve duke paraqitur një raport vjetor për ecurinë.

Aftësitë dhe karakteristikat e sugjeruara:

- Të ketë njohuri dhe përvojë në mbrojtjen e fëmijëve dhe të drejtat e fëmijëve
- Të kenë respektin dhe autoritetin e duhur nga zyra vendore dhe mendimet e tij/saj të vlerësohen
- Të ketë aftësi të mira komunikimi me të rriturit dhe fëmijët
- Të jetë në gjendje të ruajë qetësinë kur një ngrihet një shqetësim, veçanërisht nëse fëmija ka nevojë për ndihmë
- Të jetë në gjendje të punojë me të tjerët për t'u siguruar që politika zbatohet, dhe të jepet përgjigje kur ndodh një incident në lidhje me mbrojtjen e fëmijës
- Të ketë përkushtim për t'i mbrojtur fëmijët dhe përkrahur të drejtat e tyre, së bashku me aftësinë për të advokuar për ta siguruar këtë mbrojtje
- Të jetë në gjendje ta mbajë informacionin konfidencial

Raportimi i shqetësimeve dhe incidenteve për mbrojtjen e fëmijëve

- Shqetësimet dhe raportimet mund të vijnë nga një sërë burimesh, duke përfshirë stafin, prindërit, fëmijët dhe anëtarët e familjeve/komunitetit. Të gjitha shqetësimet dhe raportimet duhet të trajtohen me seriozitet të plotë.
- Raportimi i rasteve të dyshuara për abuzimin e fëmijëve është detyrim ligjor për edukatorët, drejtueset, dhe shërbimet mbështetëse në cerdhe dhe kopështe.
- Pika kryesore e referimit për çdo shqetësim të dyshuar është Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve në kopësht dhe cerdhe. Kjo nuk nënkupton që personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve është përgjegjës për veprimin, por ai/ajo duhet përfshihet në vendimmarrje.
- Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e Fëmijëve vë në dijeni Drejtoreshën e kopshtit/cerdhes.
- Pjesë e menaxhimit të shqetësimit bëhet dhe psikologu apo punonjësi social i nominuar në kopësht/cerdhe
- Vendimet rreth incidenteve për mbrojtjen e fëmijëve nuk duhet të merren vetëm nga punonjësi. Megjithatë, në rrethana të veçanta, si në situata të kërcënimit me jetë, stafi mund të ndërmarre çfarëdolloj veprimi që e shohin si të nevojshëm për të mbrojtur një fëmijë në rrezik të drejtpërdrejtë.
- Për hir të minimizimit të dëmit dhe njohjes më të plotë të natyrës së rastit, fëmijës dhe familjes; rekomandohet që rasti të zgjidhet brenda institucionit të cerdhes/kopështit në bashkëpunim me mesueset/edukatorët, personin e kontaktit për mbrojtjen, drejtoreshën e institucionit, psikologun dhe prindin.
- Vendimi i referimit shkon pranë Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve të Bashkisë Elbasan.
- Vendimi nëse rasti i një fëmije do t'i referohet apo jo një agjencie të jashtme për mbrojtje, duhet të merret gjithmonë në kuadër të kornizës ligjore të vendit dhe duke pasur në konsideratë interesat më të larta dhe dëshirat e fëmijës.
- Kur ngrihen shqetësime apo bëhen raportime, i duhet kushtuar rëndësi KONFIDENCIALITETIT, si për referuesin ashtu dhe për fëmijën (ët)/të rriturit e përfshirë. Informacionet duhet të ndahen në

mënyrë të rreptë në bazë të nevojës për informacion, për të siguruar mbrojtjen e fëmijës dhe ofrimin e ndihmës së duhur.

- Të dhënat me shkrim për të gjitha raportimet e marra (madje edhe nëse raportimi është i paqartë), duhet të mbahen dhe ruhen në një vend të sigurt dhe konfidencial nga personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve.

Vizitorët, praktikantët dhe vullnetarët

Në kopshtet dhe cerdhet kanë akses prindër, stafe të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të ushqimit, apo administrimit të godinave. Gjithashtu, vizitorët zyrtarë mund të vizitojnë një cerdhe, kopësht apo aktivitet ku përfshihen fëmijë të Bashkisë Elbasan.

Të gjithë vizitorët dhe vullnetarët e rastit duhet të jenë të informuar dhe ta kuptojnë **Udhëzuesin e Bashkisë Elbasan për vizitorët, vullnetarët dhe praktikantët** si dhe të pranojnë termat dhe kushtet para se të bëhet vizita.

Është përgjegjësi e Administratorëve të kopshteve/cerdheve dhe personit të kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve në kopësht/cerdhe të sigurojë që vullnetarët, praktikantët e rastit dhe vizitorët njoftohen si duhet dhe mbikëqyren gjatë gjithë aktiviteteve apo vizitës, dhe se e kanë nënshkruar Udhëzuesin për vizitorët, vullnetarët e dhe praktikantët.

Udhëzues për Vizitorët, praktikantët dhe vullnetarët

Ky informacion ka për qëllim së pari t'i mbrojë fëmijët si dhe të minimizojë rrezikun që vizitorët, vullnetarët apo praktikantët të akuzohen gabimisht për sjellje të papërshtatshme apo abuzim.

Duke pranuar të jeni vullnetar, vizitor apo praktikant, ju pranoi të veproni në pajtim me këtë udhëzim bazuar në kushtin se nëse nuk i përmbaheni këtyre kushteve, atëherë përvoja juaj e vullnetarizmit do të ndërpritet apo vizita do të përfundohet.

Kur fëmijët në kopështe dhe cerdhe janë në kontakt me vizitorë, praktikantë apo vullnetarë:

- Sigurohuni që fëmijët janë veshur siç duhet në fotografi dhe imazhe dhe jo në pozicione që mund të interpretohen si seksuale.
- Mbrojeni sigurinë dhe privatësinë e fëmijëve dhe familjeve të tyre duke mos i postuar fotografite e tyre në internet pa pëlqimin e qartë të prindërve, apo duke i përdorur në ndonjë mënyrë që zbulon identitetin ose vendbanimin e fëmijëve dhe familjes së tyre.
- Mos i përdorni fotografite dhe imazhet e fëmijëve për të përfituar financiarisht apo për qëllime gazetarie.
- Për të siguruar minimizimin e rrezikut të krijimit të marrëdhënieve të dëmshme, nuk këshillohet korrespondenca ndërmjet vizitorëve dhe fëmijëve.
- Vullnetarët, praktikantët, vizitorët nuk duhet të krijojnë marrëdhënie të veçanta me fëmijët dhe t'i zhvillojnë ato jashtë ambientit normal të punës.
- Vullnetarët, praktikantët, vizitorët nuk duhet të shkëmbejnë të dhëna kontakti gjatë takimeve me fëmijët.
- Të gjitha mundësitë e vullnetarizmit dhe vizitat në kopështe dhe cerdhe duhet të caktohen zyrtarisht, me lejen e përfaqësuesit të institucionit.
- Merrni pëlqimin e fëmijës dhe prindërve të tij/saj apo kujdestarëve para fotografimit apo

përdorimit të fotografive.

- Fotografoni dhe përdorini fotografitë e fëmijëve të cilat janë të denja dhe tregojnë respekt dhe nuk i paraqesin si viktimë, vulnerabël apo të nënshtruar.

Si vizitor, praktikant apo vullnetar unë:

- Do të ndjek drejtimet dhe udhëzimet e personit të kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve në kopësht/cerdhe, i cili është caktuar për të mbikëqyrur punën time apo për të më shoqëruar në vizitë.
- Do t'i trajtoj fëmijët, familjet dhe komunitetet e tyre në mënyrë të barabartë dhe me respekt për privatësinë e tyre, për shembull duke mos hyrë në shtëpitë e tyre pa ftesë dhe duke mos favorizuar një fëmijë të caktuar.
- Do të bëj fotografi, video dhe imazhe sipas praktikës së mirë të përshkruar në këtë udhëzues.
- Do të diskutoj çdo shqetësim që kam lidhur me mirëqenien e fëmijës me personin e kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve.
- Do të pyes anëtarët e stafit të cerdhes/kopështit kur nuk jam i sigurt se çfarë është sjellja e papranueshme.

Unë kurrë nuk do të:

- Përdor gjuhën, jap sugjerime apo ofroj këshilla që janë të papërshtatshme, fyese apo abuzive.
- Sillem fizikisht në një mënyrë që është e gabuar apo seksualisht provokuese. Për shembull: Të ledhatoj, mbaj, përqafoj, puth apo prek fëmijët në një mënyrë që është e papërshtatshme apo e ndjeshme në aspektin kulturor.
- Bëj për fëmijët gjëra të natyre personale të cilat ata mund t'i bëjnë vetë për veten e tyre.
- Lejoj apo marr pjesë në një sjellje me fëmijët që është e paligjshme, e pasigurt apo abuzive.
- Veproj në mënyra që kanë për qëllim të turpërojnë, poshtërojnë, nënvlerësojnë apo degradojnë fëmijët apo angazhohem në ndonjë formë të abuzimit emocional apo godas fizikisht një fëmijë.
- Diskriminoj, bëj trajtim sipas parapëlqimeve, apo favorizoj fëmijë të caktuar duke përjashtuar të tjerët.
- Hyj në marrëdhënie fizike dhe/apo seksuale me fëmijët
- Krijoj marrëdhënie me fëmijët të cilat në çfarëdo mënyre do të mund të konsideroheshin shfrytëzuese apo abuzive.
- Kaloj kohën vetëm me fëmijët larg prej të tjerëve.
- Ndihmoj fëmijët të largohen nga komuniteti i tyre, madje edhe me pëlqimin e prindërve/kujdestarëve, apo ofroj fëmijëve rastin të vizitojnë vendin tim të banimit.
- Shkëmbej hollësitë e kontakteve personale me fëmijët..
- Unë konfirmoj se e kam lexuar dhe kuptuar Udhëzuesin për vullnetarët, praktikantët dhe vizitorët dhe pranoj të veproj në përputhje me përmbajtjen e tij.

Data.....në.....

Emri dhe nënshkrimi.....

Media dhe Komunikimi

Fëmijët në kopështe dhe çerdhe janë tejet të ekspozuar ndaj veprimtarive me natyrë komunikimi dhe mediatike. Për këtë Bashkia konsideron shumë të rëndësishme rregullimin e këtyre veprimtarive nëpërmjet zbatimit të rregullave në lidhje me përdorimin e imazhit.

Rregulla etike që duhen respektuar në lidhje me përdorimin e imazhit të Bashkisë Elbasan

1. Të respektohet politika për mbrojtjen e fëmijëve dhe procedurat e saj.
2. Të garantohet që siguria e fëmijëve nuk do të rrezikohet nëse shpërndahen imazhe të shtëpisë së tij apo saj, komunitetit apo mjedisit.
3. Të shoqërohet nga një punonjës i Bashkisë Elbasan gjatë një raportimi (video, fotografi, etj.).
4. Të merret leja me shkrim nga prindi i cili është përgjegjës për kujdesin ndaj tij apo saj.
5. Të sigurohet që fëmija nuk do të pozohet në mënyrë të papërshtatshme (konotacionet seksuale, etj.).
6. Të mos fotografohen apo publikohen fotografitë e fëmijëve të cilët janë plotësisht të zhveshur apo të veshur në mënyrë jo të përshtatshme. Imazhet e fëmijëve të cilat mund të shfrytëzohet apo mund të jenë fyese nuk duhen përdorur.
7. Të respektohet gjithmonë dinjiteti i fëmijëve. Fëmijët nuk duhen të paraqiten si viktimë (të dobët, të dëshpëruar, etj.). Gjithashtu, historitë rreth fëmijëve duhet të synojnë jo vetëm shpalosjen e aspekteve negative të jetëve të fëmijëve, por edhe të pikave të tyre të forta, në vend të shfrytëzimit të përvojave të fëmijëve për të tërhequr vëmendjen.
8. Të bëhen fotografi dhe video në mënyrë të rezervuar dhe vetëm për përdorim profesional. Në këtë mënyrë, fotografitë e miratuara zyrtarisht mund të shpërndahen në faqet e mediave sociale. Fotografitë jozyrtare nuk duhet të postohen apo ngarkohen në faqe personale.
9. Të mos nxirret asnjë informacion që ndodhet në dosje që mund të vërë në rrezik fëmijën që është viktimë e abuzimit. Gjatë publikimit/shpërndarjes së fotografive, imazheve, historive etj., informacionet personale duhet të hiqen për të siguruar privatësinë (p.sh. emrat dhe adresat nuk duhet të përfshihen dhe nëse është e nevojshme, duhet të hiqen edhe hollësi të tjera identifikuese si emri kopështit apo çerdhes).
10. Të shfrytëzohen vetëm fotografitë në dispozicion për përdorim publik (të verifikuara dhe të vërtetuara nga një përfaqësues zyrtar i vendit dhe personi përgjegjës për komunikim audio-vizual).

Formulari i Miratimit nga Prindi

Fëmijët në kopështe dhe cerdhe marrin pjesë në veprimtari të ndryshme. Për të garantuar që fëmijët të mund të marrin pjesë të sigurt dhe që të promovohet mirëqenia e tyre, është e nevojshme marrja e aprovimit me shkrim nga Prindi apo Kujdestari i fëmijës.

Pëlqimi për veprimtarinë _____:

- ☐ Unë/Ne jap/japim pëlqimin tim/tonë për fëmijën tim/tonë (emri i fëmijës) për të udhëtuar dhe marrë pjesë në veprimtaritë e kopështit/cerdhes.
- ☐ Unë/Ne autorizoj/autorizojmë kopështin/cerdhes. që të jetë përgjegjëse për fëmijën tim/tonë gjatë veprimtarive dhe të marrë vendime lidhur me ndonjë trajtim urgjent mjekësor për fëmijën tim/tonë, që mund të nevojitet gjatë këtij udhëtimi.
- ☐ Unë/Ne konfirmoj/konfirmojmë se unë/ne e kam autoritetin e plotë të japim pëlqimin e kërkuar në këtë dokument.

Pëlqimi për media _____:

- ☐ Unë/Ne jap/japim pëlqimin tim/tonë për fëmijën tim/tonë për të marrë pjesë në veprimtaritë për media të cilat mund të përfshijnë fotografitë, filmat, videokasetat, audiokasetat, apo format e tjera të regjistrimit dhe të cilat mund të paraqiten në shtyp (sikur gazetat) apo 'online'.
- ☐ Unë/Ne NUK JAP/JAPIM pëlqimin tim/tonë për fëmijën tim/tonë për të marrë pjesë në veprimtaritë për media.

Unë/Ne konfirmoj/konfirmojmë se unë/ne e kam/kemi lexuar dhe kuptuar Formularin e Pëlqimit të Prindit, dhe jam dakord të veproj në përputhje me përmbajtjen e tij.

Emri i fëmijës.....

Data.....në.....

Emri dhe nënshkrimi

(emrat e prindit(ërve)/kujdestarit(ëve).....